G2 Media sh.p.k

NIPT: K71616017T

PASQYRAT FINANCIARE

TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME
STANDARDET KOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR
VITI I MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018

Permbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR më 31 Dhjetor 2018 3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE 4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE 5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT 6
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE 7
1. Informacion i Pergjithshem 7
2. Politikat kryesore kontabile 8
3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit 13
4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to 13
5. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra 13
8. Aktive afatgjata jomateriale 15
9. Llogari te Pagueshme 15
10. Detyrime ndaj shtetit 15
11. Te tjera detyrime afatshkurtra 16
12. Shitjet neto 16
13. Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit 16
14. Kosto e Punes 17
15. Amortizimi dhe zhvleresimet 17
16. Te ardhura dhe shpenzime nga interesi 17
17. Fitim / humbjet nga kursi i kembimit 17
18. Llogaritja e tatimit mbi fitimin 17
19. Vijimesia 18

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR më 31 Dhjetor 2018

AKTIVET	Shënime	31.12.2018	31.12.2017
I. Aktivet afatshkurtra			
1. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	4	714,121	30,945
2. Aktive financiare afatshkurtra		-	-
3. Inventari		-	-
4. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	5	69,939,819	-
5. Llogari te arketueshme		-	-
6. Te tjera te arketueshme	6	2,884,101	1,020,776
Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)		**73,538,042**	**1,051,721**
II. Aktivet afatgjata			
1. Investimet financiare afatgjata		-	-
2. Aktive afatgjata materiale	7	6,815,505	5,986,414
3. Aktivet afatgjata jomateriale	8	3,881,740	-
4. Aktivet afatgjata te tjera		-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		**10,697,245**	**5,986,414**
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		**84,235,286**	**7,038,135**

DETYRIMET DHE KAPITALI			
I. Detyrimet afatshkurtra			
1. Huatë afatshkurtra		-	-
2. Llogari te Pagueshme	9	20,816,905	-
3.Detyrime ndaj shtetit	10	3,854,474	12,156
4. Parapagime të arkëtuara		-	-
5. Të tjera detyrime afatshkurtra	11	9,008,792	-
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra (I)		**33,680,171**	**12,156**
II. Detyrimet afatgjata			
1. Huatë afatgjata		-	-
2. Detyrime te tjera afatgjata		62,507,650	1,095,007
3. Llogari te Pagueshme Afatgjata		-	-
4. Parapagime afatgjata		-	-
Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		**62,507,650**	**1,095,007**
Totali i detyrimeve (I + II)		**96,187,821**	**1,107,163**
III. Kapitali			
1. Kapitali aksionar		10,000,000	10,000,000
2. Prime te lidhura me kapitalin		-	-
3. Rezerva statutore dhe ligjore		-	-
4. Rezerva te tjera		-	-
5. Fitimet e pashpërndara		(4,069,028)	(4,148,314)
6. Fitimi (humbja) e vitit financiar		(17,883,506)	79,286
Totali i Kapitalit (III)		**(11,952,535)**	**5,930,972**
TOTALI I PASIVEVE (I,II,III)		**84,235,286**	**7,038,135**

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018

	Shënime	2018	2017
I. Te ardhurat			
1. Shitjet neto	12	370,260	1,515,520
2. Te ardhura te tjera		-	-
Total i te ardhurave		**370,260**	**1,515,520**
II. Shpenzimet			
1. Mallrat, lendet e para dhe sherbimet		-	-
2. Shpenzime te tjera	13	(5,510,877)	(403,924)
3. Kosto e punes	14	(12,689,634)	(350,100)
4. Amortizimi dhe zhvleresimet	15	(167,861)	(665,157)
Totali i shpenzimeve		**(18,368,372)**	**(1,419,181)**
FITMI NGA VEPRIMTARIA KRYESORE (I+II)		**(17,998,112)**	**96,339**
III. Te ardhura & shpenzime financiare			
1. Te ardhura dhe shpenzime nga interesi	16	21	-
2. Fitimet/humbjet nga kursi I kembimit	17	114,584	-
3. Te ardhura & shpenzime te tjera financiare		-	-
Totali i te ardhura & shpenzime financiare		**114,605**	**-**
FITIMI PARA TATIMIT (I+II+III)		**(17,883,506)**	**96,339**
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	18	-	(17,053)
FITMI NETO I VITIT FINANCIAR		**(17,883,506)**	**79,286**

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018

	Viti Ushtrimor 31.12.2018	Viti Ushtrimor 31.12.2017
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shrytezimit		
1. Fitimi para tatimit	(17,883,506)	96,339
2. Rregullime per Amortizimin	167,861	665,157
3. Rritje /Renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme	(1,863,325)	343,652
4. Rritje /Renie ne Shpenzimet e Periudhave te ardhshme	(69,939,819)	-
5. Rritje /Renie ne tepricen e detyrimeve	33,668,015	(14,825)
MM neto nga aktiviteti i shfrytezimit	**(55,850,775)**	**1,090,323**
II. Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
1. Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	(3,931,830)	-
2. Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(946,862)	-
3. Ta ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
4. Interesi I arketuar	-	-
MM neto, perdorur ne aktivitetet investuese	**(4,878,692)**	**-**
III. Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
1. Hyrje nga rritja e kapitalit aksioner	-	-
2. Hyrje nga huamarrje afatgjata	61,412,643	(1,150,000)
3. Hyrje nga huamarrje te tjera afatgjata	-	-
MM neto e perdorur ne aktivitetet financiare	**61,412,643**	**(1,150,000)**
Rritja /renia neto e mjeteve monetare	**683,177**	**(59,677)**
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	**30,945**	**90,622**
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	**714,122**	**30,945**

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali aksionar	Primi I aksionit	Rezerva statutore dhe ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i pashperndare	Totali
Pozicioni me 1 Janar 2018	10,000,000	-	-	-	(4,069,028)	**5,930,972**
Emetim i kapitalit aksioner	-	-	-	-		-
Dividendët e paguar	-	-	-	-		-
Rritje me kontribute te tjera	-	-	-	-		-
Rritje e rezerves se kapitalit	-	-	-	-		-
Fitimi (humbja) e vitit	-	-	-	-	(17,883,506)	**(17,883,506)**
Pozicioni me 31 Dhjetor 2018	**10,000,000**	-	-	-	**(21,952,534)**	**(11,952,534)**

Shenimet shpjeguese nga faqja 1 deri ne 18 jane pjese integrale e ketyre pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare dhe shenimet shpjeguese jane miratuar nga drejtimi me date 27.03.2019 dhe jane nenshkruar ne emer te tij nga:

Andri KASNECI
Administrator

Edon SHKEMBI
Specialist Finance

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Informacion i Pergjithshem

Organizimi

Shoqeria "G2 Media" sh.p.k eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me vendim te ortakeve te dates 02.12.2004 dhe eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me dt 02.12.2004. Shoqeria me 2/2/2018 ka ndryshuar emrin e saj nga"ALBANIA BYATY" shpk ne "G2 MEDIA" shpk. Shoqeria eshte regjistruar prane organeve tatimore me numrin unik te identifikimit K71616017T.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Objekti dhe Kontributet

Shoqeria "G2 Media" sh.p.k ka si objekt veprimtarine televizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim i programeve, informacioneve te çdo lloji te zerit, figures, sinjaleve te koduara, etj, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve, apo me çdo mjet tjeter.

Ne vitin 2018 kjo shoqeri ka kryer aktivitetin ne media autovizive.

Kontributi ne shoqeri perfaqesohet nga kapitali i ortaku, per te cilet detajet e plota jane paraqitur ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne daten 02.02.2018 ortaku i mpershem i kompanise Zj.Elida Llupa i ka shitur 100% te kuotave shoqerise "Gener 2" sh.p.k, e cila eshte zoterues 100% e kuotave te shoqersie "G2 Media" sh.p.k.

Kontributi ne kapitalin e shoqerise perfaqesohet nga kapitali ortakeve.

Kapitali i shoqerise paraqitet ne shumen 10,000,000 leke, kapital i regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit me ndarjen sipas ortakeve paraqitet si me poshte:

Ortaket	%	Vlera e Kapitalit
Gener 2 sh.p.k	100%	10,000,000
TOTAL	**100%**	**10,000,000**

Pronesia mbi Aktivet

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne ambiente qera me adresene Njesine Bashkiake Nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, ABA Business
Center, Kati 10-te. Aktivet e saj perbehen nga: makineri e paisje pune, pajisje zyre dhe informatike.

Administrimi

Shoqeria drejtohet nga Administratori z.Andri Kasneci, te cilit i perkasin te gjitha kompetencat per drejtimin ekzekutiv te pergjithshem.

2. Politikat kryesore kontabile

2.1 Bazat e pergatitjes

Deklarimet financiare te bashkangjitura jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit 9228 date 29 Prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.
Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekononike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet.
Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

2.2 Instrumentat financiare

Kompania ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vleren e drejte plus, çdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhura me to, pervec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njohjes fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrejdhat e ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financiar kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivite financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet ne daten e shitblerjes psh. daten ne te cilen kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me, nese detyrimet e Kompanise te specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anullohen.

Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e kostos se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

Detyrime te pagueshme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

Huate bankare dhe te tjera

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur çdo diference midis kostos dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

Te tjera

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metoden e interest efektiv, minus cdo humbje nga zhvleresimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne piken 2.8.

Aktivet fianciare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur kompania ka te drejte te pakushtezuar te ndryshoje marreveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

2.3 Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i

referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore ojektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar.

2.4 Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.
Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.
Metoda per llogaritjen e amortizimit eshte mbi bazen e metodes zbritese.
Toka dhe Ndertimet ne Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.
Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

2.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Ne bilanc AAJM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.
Aktivet Afatgjata Jo Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

2.6 Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Njihet 1(nje) kuote me vlere 10,000,000 leke.

2.7 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile te aktiveve jofinanciare te Kompanise, pervec inventareve dhe tatimeve te shtyra rishikohen ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ekziston ndonje tregues i tille atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabile e nje aktivi eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e madhja mes vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdorim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdorur normen e skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivit.
Per humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cilit humbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Nje humbje nga zhvleresimi anullohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera per percaktimin e vleres se rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anullohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe

do te ishte percaktuar nese zhvleresimi nuk do te kishte ndodhur.

2.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktivi financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te flukseve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive fianciare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjeter e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anullohet nese ajo mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi njohjes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anullimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

2.9 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vleren e drejte te përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe sherbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te Kompanise.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.
Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

2.10 Shpenzimet

Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

2.11 Te ardhurat dhe shpenzimet finaciare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit

efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

2.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne diten e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm pët të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2.13 Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne Leke (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
EURO	123.42	132.95
USD	107.82	111.10

3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit

Çelja e vitit 2018 rakordonte me mbylljen e vitit 2017.

4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Aktivet monetare perfshijne vlerat ne arke e banke, investime afatshkurtra qe jane shume likuide dhe te konvertueshme ne vlera te njohura monetare dhe vetem me nje humbje jomateriale ne vlere monetare.
Aktivet monetare ne bilanc i korrespondojne vlerave te mjeteve monetare te percaktuara si me siper dhe detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Arka	643	1,267
Banka	713,478	29,678
Totali	**714,121**	**30,945**

5. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe Shpenzime te shtyra perfaqesojne shpenzimet qe ju perkojne periudhave te ardhshme.
Ne tabelen e meposhtme, paraqiten detajet ne 31.12.2018 dhe 31.12.2017:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	69,939,819	-
Totali	**69,939,819**	**-**

6. Te tjera te arketueshme

Llogari te tjera te arketueshme per gjendjen e tyre me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017, paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Tatim Fitimi	14,325	-
TVSH	2,869,776	1,020,776
Totali	**2,884,101**	**1,020,776**

7. Aktive afatgjata materiale

Shoqeria ka nje vlere neto te aktiveve afatgjata materiale 6,815,505 leke dhe eshte vleresuar me koston e marjes se tyre zbritur amortizimin.

Ne tabelen e meposhtme, jane paraqitur detajet per levizjet e aktiveve afatgjata materiale dhe amortizimin sipas kategorive, per 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017:

	Toka	Ndertesa & Instalime	Makineri & Pajisje	Mjete Transporti	Aktive te Tjera	Totali
Aktive te Trupezuara						
Gjendje 01.01.2018	-	-	8,769,680	-	-	8,769,680
Shtesa	-	-	-	-	946,862	946,862
Pakesime	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2018	**-**	**-**	**8,769,680**	**-**	**946,862**	**9,716,542**
Amortizimi						
Gjendje 01.01.2018	-	-	2,783,266	-	-	2,783,266
Amortizimi i AAM i vitit 2018	-	-	101,687	-	16,084	117,771
Pakesimi i Amortizimit 2018	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2018	**-**	**-**	**2,884,953**	**-**	**16,084**	**2,901,037**
Vlera neto 01.01.2018	-	-	5,986,414	-	-	5,986,414
Vlera neto 31.12.2018	**-**	**-**	**5,884,727**	**-**	**930,778**	**6,815,505**

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat" ne vlere 117,771 leke, vlere e cila eshte njohur ne shpenzimet e vitit.

8. Aktive afatgjata jomateriale

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Programe kompjuterike - Vlera Bruto	3,931,830	-
Amortizim i Akumuluar	-	-
Amortizim i Vitit	(50,090)	-
Vlera Neto	**3,881,740**	**-**

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat" ne vlere 50,090 leke, vlere e cila eshte njohur ne shpenzimet e vitit.

9. Llogari te Pagueshme

Llogarite e Pagueshme perbehen nga shuma e detyrimeve ndaj furnitoreve. Detajet per gjendjen me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Teratek	11,897,688	-
Gener 2	3,953,773	-
McCann Tirana	2,401,279	-
Big Picture	740,520	-
Albtours Vas Tour	669,996	-
Comfortably Numb	308,550	-
Brick Biro	222,156	-
Mak Albania	144,142	-
Drazen Simic	123,420	-
Albanian Telecommunication Union	105,823	-
Furnitore te tjere	249,558	-
Totali	**20,816,905**	**-**

10. Detyrime ndaj shtetit

Detyrime ndaj shtetit perfaqeson kryesisht shumen e detyrimeve per sigurimet shoqerore & shendetesore si dhe tatimin mbi te ardhurat personale, qe i perkasin pagave te muajit dhjetor 2018. Keto detyrime jane paguar sipas dispozitave ligjore ne Janar 2019.

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Tatim mbi te ardhurat	1,481,656	-
Sigurime shoqerore	2,199,186	6,975
Tatim ne burim	173,632	2,985
Tatim fitimi	-	2,196
Totali	**3,854,474**	**12,156**

11. Te tjera detyrime afatshkurtra

Te tjera detyrime afatshkurtra, perfaqesojne pagat per t'u paguar qe i perkasin muajit dhjetor 2018, te cilat jane paguar ne Janar 2019.

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Te Pagueshme ndaj Punonjesve	9,008,792	-
Totali	**9,008,792**	-

12. Shitjet neto

Shoqeria per vitin 2018 ka realizuar shitje neto, detajuar si me poshte :

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Shitje te drejte trasmetimi	370,260	1,515,520
Totali	**370,260**	**1,515,520**

13. Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet, detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Qera Zyrash & Pajisjesh	3,421,515	238,800
Sherbime ne platformat e transmetimit	370,260	39,033
Mirëmbajtje dhe riparime	327,044	12,000
Sherbime Konsulence	173,632	-
Sherbime Perkthimi	120,270	-
Taksa, Tatime, Tarifa, etj.	118,789	90,044
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	165,598	-
Shpenzime për shërbimet bankare	130,234	6,700
Transferime, udhëtime, dieta	27,529	-
Blerje te tjera	376,265	-
Sherbime te tjera	279,258	-
Gjoba dhe dëmshpërblime	482	17,347
Totali	**5,510,877**	**403,924**

14. Kosto e Punes

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore, detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Paga	11,386,649	300,000
Sigurime shoqerore	1,302,985	50,100
Totali	**12,689,634**	**350,100**

15. Amortizimi dhe zhvleresimet

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat".

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Amortizimi i AAM (shiko noten 7)	117,771	665,157
Amortizimi i AAJM (shiko noten 8)	50,090	-
Totali	**167,861**	**665,157**

16. Te ardhura dhe shpenzime nga interesi

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi, per vitin ushtrimor 2018 dhe 2017, paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Te ardhura nga interesat	21	-
Shpenzime per interesa	-	-
Totali	**21**	**-**

17. Fitim / humbjet nga kursi i kembimit

Fitim / humbjet nga kursi i kembimit, per vitin ushtrimor 2018 dhe 2017, paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Fitime nga kembimet valutore	162,812	-
Shpenzim nga kembimet valutore	(48,228)	-
Totali	**114,584**	**-**

18. Llogaritja e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatim fitimit jane llogaritur sipas dispozitave ligjore tatimore ne daten e mbylljes se bilancit. Detajet e llogaritjeve jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Fitimi/ Humbja Bruto	(17,883,506)	96,339
Humbje e mbartur	-	-
Shpenzime te panjohura	482	17,347
Baza e llogaritjes Tatimit	(17,883,024)	113,686
% e Tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	**-**	**17,053**
Fitimi / Humbja NETO	**(17,883,506)**	**79,286**

19. Vijimesia

Kompania deklaron qe nuk ka problem me vijemesine e aktivitetit.